



KËSHILLI I QARKUT KORÇË



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Nr. 757 Prot

Dt. 04.10.2024

Nr. 278 Prot

Dt. 01.10.2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
KËSHILLIT TË QARKUT KORÇË
DHE
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Sot më datë 01.10..2024 lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet palëve:

“KËSHILLI I QARKUT KORÇË”, përfaqësuar nga **Z. ERJON NEXHIPI**, Kryetar i Këshillit të Qarkut Korçë,

dhe

“UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS”, përfaqësuar nga **Z. FATBARDH SALLAKU**, Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

NENI 1

Qëllimi i kësaj marrëveshje është përcaktimi i bashkëpunimit, ndarja e roleve të institucioneve të mësipërme dhe planifikimi i aktiviteteve të përbashkëta në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe agrobiznesit. Kjo marrëveshje synon të lehtësojë dhe promovojë shkëmbimin e përvojave dhe eksperiencave midis Këshillit të Qarkut Korçë dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), në fushat e studimit dhe të kërkimit për cështje të përbashkëta, si dhe të promovojë vecanërisht

eksperiencave midis Këshillit të Qarkut Korçë dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), në fushat e studimit dhe të kërkimit për çështje të përbashkëta, si dhe të promovojë vecanërisht zhvillimin e programeve të përbashkëta studimore, projekteve, seminareve dhe arritjeve në kuadër të këtij bashkëpunimi.

NENI 2

Palët marrin përsipër të bashkëpunojnë në planifikimin dhe zbatimin e praktikave mësimore dhe profesionale të studentëve , por edhe për ti ardhur në ndihmë fermerëve dhe shoqatave të tyre, (që mbulon Qarku Korçë), për identifikimin dhe zgjidhjen e mjaft problemeve që ata kanë në fushën e bujqësisë, blegtorisë dhe biznesit bujqësor.

NENI 3

Bashkëpunimi do të synojë gjithashtu edhe në mbarëvajtjen e ecurisë së programeve aktuale të studimit që ofron Universiteti Bujqësor i Tiranës, si dhe në mbështetje që do të japë Këshilli i Qarkut Korçë për celjen e programeve të reja të studimit, të cilat do të kërkohen nga tregu i punës si dhe nga nevojat që do të ketë rajoni ynë për specialistë të profesioneve të ndryshme të fushës së bujqësisë.

NENI 4

Palët marrin përsipër të shkëmbejnë informacione rregullisht në lidhje me arritjet dhe problemet që janë evituar në fushën e bujqësisë dhe ekonomisë bujqësore, si dhe të shkëmbejnë botime, e literaturë bashkëkohore. Ato marrin përsipër mundësimin e seminareve, takimeve si dhe aplikimin për projekte të përbashkëta, duke i kushtuar një vëmendje të vecantë implementimit të projekteve të përbashkëta në kuadrin e bashkëpunimit rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

NENI 5

Duke pasur parasysh mjetet financiare që ka në dispozicion cdo institucion, mbi bazën e programeve të ndryshme që mund të ndërmerren gjatë gjithë periudhës së bashkëpunimit, palët kanë rënë dakort që të organizojnë here pas here takime pune për shkëmbim përvojash dhe idesh

me stafet e tyre si: kërkues shkencorë, student, si dhe anëtarë të personelit petagogjik dhe administrativ, për përmbushjen me sukses të kësaj marrëveshje.

NENI 6

Brenda limiteve të rregullores Universitetit Bujqësor i Tiranës do të bëjë të gjitha përpjekjet për të kërkuar burime financiare nga Universiteti me qëllim që të plotësohen tërësisht shpenzimet e duhura për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve apo aktiviteteve të ndryshme promovuese.

NENI 7

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë tre vjecare. Secila nga palët mund të kërkojë tërheqjen nga kjo marrëveshje në çdo kohë duke bërë një njoftim me shkrim gjatë muaj para. Nëse asnjë nga palët nuk do ta bënte një gjë të tillë, marrëveshja do të konsiderohej e rinovuar për një periudhë të mëtejshme tre vjecare.

NENI 8

Marrëveshja hyn në fuqi pasi të jetë firmosur nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Korçë dhe Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Marrëveshja është e përpiluar në dy kopje. Secila nga palët do të mbajë nga një kopje origjinale të Marrëveshjes.

PËR

KËSHILLIN E QARKUT KORÇË

KRYETAR

ERJON NEXHIPI



PËR

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

REKTOR

FATBARDH SALLAKU

